

Kodeksi i mirësjelljes / Code of Conduct i kompanisë Westfleisch-Gruppe, Münster

Kodeksi i mëposhtëm i mirësjelljes përshkruan deklaratën e misionit të kompanisë Westfleisch-Gruppe dhe përcakton si „Code of Conduct“, se si duam të bashkëpunojmë në ndërmarrjen tonë. Si ndërmarrjet e kompanisë Westfleisch-Gruppe vlejnë të gjitha ndërmarrjet, në të cilat kompania Westfleisch SCE mbH ka pjesëmarrje të drejtpërdrejte ose indirekte prej të paktën 50.1 për qind.

Kodeksi përmbledh rregulla të rëndësishme parimore të sjelljes me njëri-tjetrin, që për ne të gjithë tashme sot janë të vetëkuptueshme dhe obliguese. Njëkohësisht ai ofron një orientim për të gjithë bashkëpunëtorët, eprorët dhe organet e ndërmarrjes sonë dhe u sinjalizon klientëve, partnerëve biznesi dhe publikut, se si duam të krijojmë dhe të jetojmë bashkësinë tonë.

Përgjegjësia personale e të gjithë bashkëpunëtorëve, eprorëve dhe organeve, transparenca, sjellja korrekte etike dhe ligjore kanë një rëndësi të posaçme për arritjen e këtyre qëllimeve.

Parathënie

Ne personat e kompanisë Westfleisch veprojmë në interesin e përgjithshëm të ndërmarrjes. Bashkëveprimi karakterizohet nga toleranca, sinqeriteti, vlerësimi për njëri-tjetrin, besueshmëria, çiltërsia dhe integriteti. Besnikëria ndaj ligjit dhe rregullave (Compliance) është një element thelbësor i politikës së ndërmarrjes. Përmes veprimit tonë, ne marrim përsipër një përgjegjësi të posaçme për shoqërinë dhe mjedisin. Ne angazhohemi në mënyrë aktive për një zhvillim të qëndrueshëm, gjë që shprehet përmes përkrahjes së dhjetë parimeve të Paktit Global të Kombeve të Bashkuara. Ne anëtarët e kompanisë Westfleisch ndër të tjera pohojmë Deklaratën e Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara si dhe Normat thelbësore të punës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Tek ne, rregullat konkrete janë formuluar qartazi në rregulloret dhe marrëveshjet e kompanisë, të cilat janë obliguese për të gjithë bashkëpunëtorët. Në rastin e shkeljeve të këtyre rregulloreve dhe marrëveshjeve, bashkëpunëtorët duhet të presin pasoja në kuadrin e normave të ndërmarrjes dhe të dispozitave ligjore.

Për çfarë duam të kujdesemi

Elemente thelbësore të Kodeksit të mirësjelljes Westfleisch

1. Zbatimi i legjislacionit dhe i ligjit

Ne i zbatojmë ligjet dhe dispozitat si një parim thelbësor i veprimit të përgjegjshëm ekonomik dhe në çdo kohë i respektojmë ndalimet dhe obligimet ligjore.

2. Trajtimi në mënyrë të barabartë

Ne i trajtojmë të gjithë bashkëpunëtorët në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga gjinia, mosha, ngjyra, kultura, origjina etnike, identiteti seksual, një nevojë e veçantë, përkatësia fetare ose botëkuptimi.

3. Jo-diskriminim

Ne angazhohemi për barazinë e shanseve dhe ndalim diskriminimin në rastin e punësimit të bashkëpunëtorëve, në rastin e ngritjeve në përgjegjësi si dhe gjatë masave të formimit dhe të arsimimit të mëtejshëm si dhe në sjelljen e përditshme me njëri-tjetrin. Bashkëpunëtorët e kompanisë Westfleisch punësohen dhe nxiten vetëm në bazë të kualifikimit dhe të aftësive profesionale të tyre.

4. Oraret e punës dhe pagat ligjore

Ne respektojmë rregullat e orarit të punës, që janë në fuqi. Ne plotësojmë pretendimin e bashkëpunëtorëve tanë për një pagë të duhur dhe i respektojmë dispozitat e ndërmarrjes dhe dispozitat ligjore në fuqi. Duke vepruar kështu, paga dhe pagesat e tjera përkojnë të paktën me dispozitat përkatëse kombëtare dhe lokale.

5. Të drejtat e njeriut

Ne i respektojmë të drejtat e njeriut të njohura në nivel ndërkombëtar dhe përkrahim zbatimin e tyre. Ne i respektojmë të drejtat personale të bashkëpunëtorëve tanë dhe të personave të tretë. Ne refuzojmë çdo formë të punës së detyruar dhe të punësimit të fëmijëve si dhe të skllavërisë si dhe çdo formë të shfrytëzimit dhe kujdesimi për një zbatim të rreptë të ligjeve përkatëse.

6. Liria e lidhjes

Ne e respektojmë të drejtën e të gjithë bashkëpunëtorëve, që në bazë demokratike dhe në kuadër të rregullave kombëtare të formojnë sindikatë dhe përfaqësime punëmarrësesh. Bashkëpunimi i ngushtë dhe plot besim me përfaqësuesit e punëmarrësve është një element thelbësor i politikës së ndërmarrjes.

7. Mbrojtja e punës dhe e shëndetit

Siguria dhe shëndeti i bashkëpunëtorëve kanë për ne një rëndësi të jashtëzakonshme duke qenë një qëllim i ndërmarrjes. Siguria e punës dhe mbrojtja e shëndetit janë një element i integruar i të gjitha proceseve të punës. Ne i zbatojmë rreptësisht të gjitha dispozitat për mbrojtjen e punës dhe të shëndetit. Sipas normativës DIN EN ISO 45001 kemi instaluar një sistem menaxhimi për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Ky përmban fushat e vlerësimit të rrezikut dhe të zvogëlimit të rrezikut, një përshkrim të sistemuar dhe të plotë të ecjes së proceseve, identifikimin e kërkesave dhe realizimin e tyre efektiv si dhe një mbikëqyrje dhe vlerësim të rregullt.

8. Ndalimi i veprimeve të caktuara nga ana e forcave të sigurisë

Ndërhyrje nga ana e forcave të sigurisë, që nuk respektojnë ndalimin e torturës, që rrezikojnë shëndetin dhe jetën ose cenojnë lirinë e bashkimit dhe të lidhjes, nuk tolerohen nga ana jonë.

9. Mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit dhe mbrojtja e bazave të jetës

Mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit është për ne një qëllim serioz i ndërmarrjes. Ne kujdesemi, që të gjitha ndikimet negative në mjedis të mbahen në nivel aq të ulët sa të jetë e mundur. Gjatë prodhimit të produkteve kujdesemi për një zbatim të rreptë ndër të tjera të ndalimeve lidhur me mjedisin në përdorimin e lëndëve të para, të lëndëve ndihmuese dhe të lëndëve të proceseve dhe ndalojmë shkelje të konventës së mjedisit për parandalimin e ndotjes së detit si dhe kundër shpërdorimit të lëndëve të caktuara të gjalla organike (Konventa e Stokholmit, Konventa e Minamatës). Ne ndalojmë përdorimin, magazinimin, heqjen, eksportin dhe importin jo të përshtatshëm të mbeturinave sipas Konventës PoPs dhe të Konventës së Bazelit. Duke pasur parasysh mirëqenien e brezave të ardhshme, synimi ynë është të merremi në mënyrë të përgjegjshme me burimet natyrore ujë, ajër dhe tokë.

10. Konkurrin i ndershëm dhe korrupsion

Ne qëndrojmë për një konkurrin të ndershëm dhe i zbatojmë rreptësisht rregullat e së drejtës për formimin e kartelave. Nuk tolerohen marrëveshje me synimin e kufizimit të konkurrimit si biseda rreth çmimeve ose rreth formimit të kartelave me konkurrentë, furnizues dhe klientë. Rreptësisht refuzojmë çdo formë të korrupsionit. Bashkëpunëtorët janë udhëzuar, që as të ofrojnë dhe as të pranojnë asnjë favorizim, që mund të çonte në ndikimin e vendimeve brenda biznesit.

11. Sjellje tjetër

Veç këtyre pikave nuk tolerojmë asnjë sjellje ose mosveprim, që drejtpërsëdrejti është i përshtatshëm, që në një mënyrë posaçërisht të rëndë të cenojë një prej pozitave të lartpërmendura të mbrojtura ligjore dhe kundërligjshmëria e të cilit bie në sy, duke vlerësuar të gjitha rrethanat që duhen marrë në konsideratë.

Procedura e ankimit dhe personi kontaktues

Për sqarimin e të gjitha pyetjeve dhe paqartësive janë në dispozicion të gjithë eprorët, drejtues degësh, drejtues filialesh dhe drejtoria e kompanisë. Kështu që të gjithë bashkëpunëtorët dhe gjithashtu personat e tretë kanë mundësi të njoftojnë shkelje të mundshme ose informata për të tilla.

Përtej kemi instaluar një zyrë asnjënjë ankimore dhe kontaktuese jashtë kompanisë tek një avokat (arbitër). Arbitri i nënshtrohet obligimit për ruajtjen e sekretit. Ankesa dhe informata mund të parashtrihen atje edhe në mënyrë anonime.

Të dhënat e kontaktit:

Arbitër për grupin e kompanive Westfleisch

Dr. Carsten Thiel von Herff, LL.M.
avokat i jashtëm

Telefoni: + 49 521 55 7 333 0
Celulari: + 49 151 58 23 03 21
E-maili: ombudsmann@thielvonherff.com
Interneti: www.report-tvh.com

Adresa postare:
Thiel von Herff Rechtsanwälte
Loebellstrae 4, 33602 Bielefeld